



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 251, Datë 25.11.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OST SH.A. PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË ALOKIMIT TË KAPACITETEVE DHE
MENAXHIMIT TË KONGJESTIONEVE**

Në mbështetje të neneve 16, 20, 23 gërma “b”, 65 pika 1 dhe 66 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.11.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2028/1 prot., datë 21.11.2024, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e Kërkesës së OST sh.a. për miratimin e Rregullores së Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestioneve”,

Konstatohet se:

- Shoqëria OST sh.a. me shkresën nr. 6532 prot., datë 30.09.2024, protokolluar me tonën me nr. 2028 prot., datë 02.10.2024, ka depozituar kërkesën për miratimin e “Rregullores për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimit të kongjestioneve”.
- Shoqëria OST sh.a. në shkresën e sipërcituar ndër të tjera sqaron se: “Këshilli Ministeror i Komunitetit të Energjisë në takimin e datës 14-15 Dhjetor 2022, ka miratuar vendimin për plotësimin e “Paketës së Energjisë së Pastër” për energjinë elektrike duke amenduar një sërë aktesh të cituara në këtë shkresë. Zbatimi i kësaj pakete do të krijojë përfitime të rëndësishme për Palët Kontraktuese dhe do të lehtësojë integrimin dhe tregtimin e energjisë elektrike të gjeneruar nga burimet e rinovueshme. Këshilli Ministeror ka theksuar rëndësinë e kësaj pakete për integrimin e plotë të tregjeve të energjisë elektrike të Palëve Kontraktuese në sistemet evropiane dhe rajonale të krijuara në Bashkimin Evropian. Në vijim të Strategjisë së Implementimit dhe Transpozimit të dakordësuar ndërmjet Bankës Botërore (nëpërmjet asistencës teknike të konsulentit OMNIA gmbh) dhe OST sh.a., në bashkëpunimin edhe me ALPEX sh.a. dhe grupit lokal të konsulencës është përgatitur drafti i “Rregullores së Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestioneve”.
- Rregullorja e Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestioneve (CACM) është një dokument që përcakton udhëzime dhe rregulla të harmonizuara për alokimin e kapaciteteve ndër-zonal dhe menaxhimin e kongjestioneve në tregjet e energjisë elektrike. Ajo transponon

Rregulloren (BE) 2015/1222 (Rregullorja e Komisionit (BE) 2015/1222, datë 24 Korrik 2015, për miratimin e një udhëzimi mbi ndarjen e kapaciteteve dhe menaxhimin e mbingarkesës) dhe është në përputhje me vendimet e Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë, duke synuar integrimin e tregjeve të energjisë elektrike të Ballkanit Perëndimor me ato të Bashkimit Evropian.

- Qëllimi i rregullores është të krijojë kushtet për lehtësimin e tregtimit të energjisë elektrike në të gjithë Bashkimin Evropian dhe tashmë edhe në vendet e Komunitetit të Energjisë, të mundësojë përdorimin më efikas të rrjeti dhe të ndikojë në rritjen e konkurrencës në përfitim të konsumatorëve të të gjitha kategorive.
- Objektivat e Rregullores së Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestionave janë të përshkruara në Nenin 3 të saj. Ato përfshijnë:
 - Promovimi i konkurrencës efektive në prodhimin, tregtimin dhe furnizimin me energji elektrike;
 - Sigurimi i përdorimit optimal të infrastrukturës së transmetimit. Garancia për sigurinë e operimit të rrjetit elektroenergjetik;
 - Optimizimi i llogaritjes dhe alokimit të kapacitetit ndër-zonal;
 - Sigurimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminues për të gjithë operatorët e sistemit të transmetimit (OST), tregtarët e energjisë (NEMO-t), rregullatorët dhe pjesëmarrësit e tregut;
 - Rritja e transparencës dhe besueshmërisë së informacionit;
 - Mbështetja për zhvillimin afatgjatë të sektorit të energjisë në Komunitetin e Energjisë;
 - Respektimi i kërkesave për një treg të drejtë dhe të rregullt për formimin e çmimeve të energjisë;
 - Ofrimi i kushteve mosdiskriminuese për aksesin në kapacitetin ndër-zonal.
- Rezulton se rregullorja parashikon detyra për pjesëmarrësit e tregut, duke përfshirë llogaritjen e kapacitetit, menaxhimin e kufizimeve të alokimit, implementimin e metodologjive për bashkimin e tregjeve të energjisë dhe ofrimin e transparencës së informacionit.
- Për sa më sipër vlerësohet që ERE të zhvillojë seanca dëgjimore për të sqaruar arsyen e këtij propozimi dhe shqyrtimin e kërkesës për miratimin e rregullores duke përfshirë dhe konsultimin publik me palët e interesuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestionave”.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë shoqërinë OST sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI